



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

KUSH E AUDITON PARANË PUBLIKE NË KOSOVË?



“

Auditimi i sektorit publik, i kryer nga Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të), është një faktor i rëndësishëm për të bërë ndryshim në jetën e qytetarëve.

”

“

ISA-të forcojnë llogaridhënien, transparencën dhe integritetin duke audituar operacionet e sektorit publik në mënyrë të pavarur dhe duke raportuar të gjeturat e tyre

”

*INTOSAI-P 12 Vlerat dhe përfitimet e ISA-ve
sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve*

KUSH JEMI NE?

“Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar”

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

“Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është institucion i pavarur që ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij”

Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Auditori i Përgjithshëm ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve. AP ka të drejtën të përcjellë fondet publike deri tek përfituesi i fundit.

Auditori i Përgjithshëm ushtron mandatin e tij në pajtim me legjislacionin vendor dhe Kornizën e INTOSAI-t për Standardet Profesionale (KISP).

Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e auditimit promovojnë llogaridhënien dhe ofrojnë bazë të qëndrueshme për t’u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.


Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) harton dhe dorëzon në Kuvend dhe tek subjektet e audituara, mbi 100 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performancës. Po ashtu, rreth 1,000 rekomandime të auditimit jepen çdo vit për organizatat buxhetore.

Të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në faqen e ZKA-së www.zka-rks.org.

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Vizioni

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve




Misioni

Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare

ÇKA BËJMË NE?

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me mandatin e saj ligjor, kryen kryesisht këto lloje të auditimeve:



**Auditimet e
rregullësisë
(financiare dhe të
pajtueshmërisë)**

kanë për qëllim rritjen e nivelit të besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimin e fondeve publike në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe rregullative.

**Auditimet e
performancës**

janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.

**Auditimet e
Teknologjisë së
Informacionit**

si auditime të veçanta janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë dhe efektivitetit të sistemit të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

PORTOFOLI I PËRGJITHSHËM I AUDITIMEVE

Llojet e auditimit	Vitet			
	2020	2019	2018	2017
Auditime të rregullsisë	119	115	109	99
Buxheti i Kosovës	1	1	1	1
Institucione qendrore	57	56	54	54
Komuna	38	38	38	38
Ndërmarrje publike	14	11	9	4
Projekte	9	9	7	2
Auditime të performancës	8	13	13	11
Performancë	5	11	10	9
Teknologji Informative	3	0	3	2
Projekte	-	2	-	-
Gjithsej	127	128	122	110

	Auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator, ndërsa përfundojnë me raportet e auditimit, të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.
	Auditimet e performancës	Fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit të auditimeve të performancës përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese, si dhe kriteret e tjera përkatëse.


CILI ËSHTË NDIKIMI YNË?

Përmes auditimeve cilësore Zyra Kombëtare e Auditimit synon t'i ndihmojë institucionet publike që të përmirësojnë qeverisjen në sektorin publik në interes të qytetarëve.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është treguesi më i mirë për të kuptuar nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar gabimet dhe parregullsitë.

Përmes raporteve të auditimit, gjatë viteve 2017-2019 ZKA-ja ka dhënë **3,512 rekomandime**. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve është mbi 40%, ndërsa rekomandimet në proces 12%.

Numri i rekomandimeve



Numri i raporteve të auditimit të shqyrtuara në Kuvend




Gjatë tri viteve të fundit, Kuvendi i Kosovës, përmes komisioneve parlamentare ka shqyrtuar **67 raporte të auditimit**.




SI FUNKSIONOJMË NE?

Zyra Kombëtare e Auditimit udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm i cili ka mandat kushtetues dhe emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozim të Kryetarit të Republikës për periudhë pesë vjeçare.

Zyra Kombëtare e Auditimit është themeluar si institucion i pavarur për të mbështetur Auditorin e Përgjithshëm në përmbushjen e mandatit kushtetues të tij/saj.



STAFI YNË




Personeli auditues është i trajnuar dhe certifikuar, si dhe ka përvojën e duhur për të zbatuar Planin Strategjik dhe Planet operative të ZKA-së.



KUSH JANË PARTNERËT TANË?

Zyra Kombëtare e Auditimit ka komunikim të frytshëm dhe qasje sistematike të bashkëpunimit me palët e interesit, e cila kontribuon në sigurimin e efektivitetit, efikasitetit dhe përmirësimin e ndikimit të punës së ZKA-së.

Komunikimi me palët e interesit zbatohet përmes strategjisë së Komunikimit të ZKA-së që ka për qëllim "Rritjen e ndikimit dhe ngritjen e vetëdijesimit publik rreth rolit të ZKA-së".



PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR?

Zyra Kombëtare e Auditimit si çdo ISA, bashkëpunon me institucione dhe organizata të ndryshme në fushat e ndërlidhura me auditimin apo zhvillimin profesional.

Si anëtare me të drejta të plotane INTOSAI-t (nga viti 2020) dhe EUROSAI-t (nga viti 2021), ZKA-ja synon të jap kontribut dhe të promovojë përveç tjerash qeverisjen e mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si dhe ngritjen e kompetencës profesionale në fushën e auditimit publik.

Përmes bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe regjionale, ZKA-ja ka për qëllim shkëmbimin e praktikave dhe përvojave me komunitetin e auditimit.



INTOSAI

Organizata
Ndërkombëtare e
Institucioneve
Supreme
të Auditimit

është organizatë autonome, e pavarur dhe jopolitike dhe ka për qëllim të ofrojë mbështetje për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit; të vendos standardet ndërkombëtare të auditimit për sektorin publik; si dhe të promovoj qeverisjen e mirë dhe të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes Institucioneve Supreme të Auditimit. Kjo organizatë ka 195 anëtarë.

EUROSAI

Organizata
Evropiane e
Institucioneve
Supreme
të Auditimit

është një nga organizatat regjionale të INTOSAI-t dhe përbëhet nga 51 anëtarë (Institucione Supreme të Auditimit të vendeve të Evropës dhe Gjykata Evropiane e Auditimit).

Departamenti për Komunikim dhe Zhvillim Profesional
Zyra Kombëtare e Auditimit

Lagjja Arbëria Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina Republika e Kosovës
www.zka-rks.org +383 (0) 38 60 60 04 ext. 1066



THËNIET E STAFIT TË ZKA-SË

“

Auditimi sektorit publik kërkon përkushtim të vazhdueshëm, integritet të lartë dhe mbi të gjitha njerëz që kanë në mendje interesin publik.

”

“

Përmes angazhimit, punës dhe profesionalizmit, stafi i ZKA-së në vazhdimësi synon të kontribuoj në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e parasë publike, duke kontribuar kështu në ngritjen e mirëqenies, të qytetarëve të vendit tonë.

”



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo

This publication was produced with the financial support of the European Union.
Its contents are the sole responsibility of National Audit Office of Kosovo and
do not necessarily reflect the views of the European Union